

VENDIM
Nr.1016, datë 10.12.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME, PËR NËNPREFEKTURËN KAVAJË, TË DISA MJEDISEVE E TË TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE 12 313.55 M², E KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KAVAJË TË DISA MJEDISEVE E TË TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE 71 967.82 M², KOMPONENTË TË PRONËS NR.353 “SHTABI I REPARTIT USHTARAK NR.8832”, KAVAJË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për nënprefekturën Kavajë, të disa mjediseve e të truallit funksional, sipas planvendosjes (S1), bashkëlidhur këtij vendimi, me sipërfaqe 12 313.55 (dymbëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) m², komponentë të pronës nr.353, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8832”, në Kavajë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për t’i përdorur për nevoja të administratës, për veprimtari social-kulturore, arsimore.

2. Kalimin në pronësi të bashkisë Kavajë të disa mjediseve e të truallit funksional, sipas planvendosjes (S2), bashkëlidhur këtij vendimi, me sipërfaqe 71 967.82 (shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e dy) m², komponentë të pronës nr.353, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8832”, në Kavajë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për t’i përdorur për ndërtim çerdheje e kopshti, për tregje ushqimore e industriale, për fusha sportive, parqe lodrash, për veprimtari social-kulturore, shëndetësore.

3. Prona me numër rendor 353, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8832”, me vendndodhje në Kavajë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515 datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Ministrisë së Brendshme, nënprefekturës Kavajë dhe bashkisë Kavajë, u ndalohet të ndryshojnë destinacionet e përdorimit të mjediseve e të sipërfaqeve, të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

5. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të kësaj prone do të bëhet pas heqjes së materialeve e të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të cilat janë magazinuar në këtë pronë.


6. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, nënprefektura Kavajë, kryetari i bashkisë Kavajë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN-VENDOSJA E REP.USHT 8832 (1304) KAVAJE


Kordinatat Shteterore



Shkalla 1:2500

PLAN-VENDOSJA E REP.USHT 8832 (1304) KAVAJE

Kordinatat Shteterore



Shkalla 1:2500

Dixhitalizoi: